PROGRAMI I TRANSPARENCËS
BASHKIA DEVOLL

DETYRAT DHE KOMPETENCAT.

Kryetari i bashkisë ka këto kompetenca dhe detyra:

ushtron të gjitha kompetencat në kryerjen e funksioneve të bashkisë, me përjashtim të atyre qëjanë kompetencë vetëm e këshillit përkatës;
zbaton aktet e këshillit;
merr masa për përgatitjen e materialeve të mbledhjeve për këshillin bashkiak, në përputhje merendin e ditës së përcaktuar nga këshilli, si dhe për probleme që kërkon ai vetë;
raporton në këshill për gjendjen ekonomiko-financiare të bashkisë dhe njësive administrative përbërëse të paktën çdo 6 muaj ose sa herë kërkohet nga këshilli;
raporton para këshillit sa herë kërkohet prej tij për probleme të tjera që kanë të bëjnë mefunksionet e bashkisë;
është anëtar i këshillit të qarkut;
emëron, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, zëvendëskryetarin/zëvendëskryetarët ebashkisë dhe i shkarkon ata;
emëron, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, administratorët e njësive administrative /lagjeve dhe i shkarkon ata;
vendos për emërimin ose shkarkimin e anëtarëve të organeve drejtuese të shoqërive tregtare nëpronësi të bashkisë, si dhe drejtuesit e ndërmarrjeve e të institucioneve në varësi;
emëron dhe shkarkon punonjësit e tjerë të strukturave dhe njësive në varësi të bashkisë, përveçkur parashikohet ndryshe në ligjin për nëpunësin civil;
ushtron të drejtat dhe siguron plotësimin e të gjitha detyrimeve që i janë ngarkuar bashkisë siperson juridik dhe është përfaqësuesi i saj në marrëdhëniet me të tretët;
merr masa për kualifikimin dhe trajnimin e personelit të administratës, të institucionevearsimore, sociale, kulturore e sportive;
kthen për rishqyrtim jo më shumë se një herë në këshill vendime, kur vëren se ato cenojnë interesa të bashkësisë. Në rastin e kthimit të vendimit të këshillit nga kryetari i bashkisë, këshilli mund të miratojë të njëjtin vendim vetëm me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmëssë të gjithë anëtarëve;
miraton strukturën, organikën e kategoritë /klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civildhe rregulloret bazë të administratës së bashkisë dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
emëron dhe shkarkon nëpunësit vendorë për barazinë gjinore;
kujdeset për mbledhjen dhe përpunimin e statistikave vendore, të ndara sipas gjinisë, dhesiguron publikimin e tyre.

Përditësuar në datë 16.03.2026